



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
Kuvendi

PROJEKTLIGJ

Nr. ____/2024

“PËR

DISA NDRYSHIME NË LIGJIN NR.162, DATË 4.12.2014 “PËR MBROJTJEN E CILËSISË SË AJRIT NË MJEDIS”, I NDRYSHUAR

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83, pika 1, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave, Kuvendi i Republikës së Shqipërisë

V E N D O S I:

Në ligjin nr.162, datë 4.12.2014 “Për mbrojtjen e cilësisë së ajrit në mjedis”, i ndryshuar, bëhen ndryshimet si më poshtë vijon:

Neni 1

Kudo në tekstin e ligjit, fjala “ISHMPU” zëvendësohet me fjalët “Struktura përgjegjëse inspektuese në fushën e mjedisit”.

Neni 2

Neni 20 ndryshon me përmbajtjen si më poshtë vijon:

“Neni 20

Kundërvajtjet

1. Çdo shkelje e kërkesave të këtij ligji dhe të akteve nënligjore, të dala në zbatim të tij, kur nuk përbën veprë penale, konsiderohet shkelje administrative dhe ndëshkohet me gjobë, pezullim apo mbyllje të veprimtarisë, përkatësisht:

a) mospërbushja dhe mosrespektimi i kërkesave, parimeve dhe kushteve të shkarkimeve në ajër nga operatori i një instalimi, referuar lejes së mjedisit të tipave A apo B:

i) për lejet e mjedisit të tipit A, dënohet me gjobë në vlerën 1 300 000 (një milion e treqind mijë) deri në 2 600 000 (dy milion e gjashtëqind mijë) lekë;

ii) për lejet e mjedisit të tipit B, dënohet me gjobë në vlerën 390 000 (treqind e nëntëdhjetë mijë) deri në 650 000 (gjashtëqind e pesëdhjetë mijë) lekë;

b) ndotja e ajrit, e shkaktuar nga burimet e lëvizshme, në kundërshtim me kërkesat e nenit 13, të këtij ligji, dënohet me gjobë në vlerën 1 300 000 (një milion e treqind mijë) deri në 2 600 000 (dy milion e gjashtëqind mijë) lekë.”

c) prodhimi, importimi, tregtimi i lëndëve djegëse nga subjektet dhe përdorimi i lëndëve djegëse nga operatori, në kundërshtim me kërkesat e shkronjave “a” dhe “b” të nenit 14, të këtij ligji, dënohen me gjobë në vlerën 1 300 000 (një milion e treqind mijë) deri në 2 600 000 (dy milion e gjashtëqind mijë) lekë, në varësi të sasisë dhe rrezikshmërisë që paraqesin lëndët djegëse të palejuara, si dhe me sekuestrimin e lëndës djegëse që është gjendje;

ç) Mosrespektimi i masave për sigurimin e informacionit mbi konsumin e lëndës djegëse dhe shkarkimet e CO₂ gjatë marketingut të automjeteve të reja, sipas kërkesave të shkronjës “c” të nenit 14, të këtij ligji, dënohet me gjobë në vlerën 200 000 (dyqind mijë) lekë ;

d) Mos përmbushja nga operatorët, e kërkesave për pakësimin e rrjedhjeve dhe shkarkimeve të përbërësve organik të avullueshëm (VOC) në kundërshtim me përcaktimet sipas shkronjave “a”, “c” dhe “ç” të nenit 15, të këtij ligji, dënohen me gjobë në vlerën 1 300 000 (një milion e treqind mijë) deri në 2 600 000 (dy milion e gjashtëqind mijë) lekë, në varësi të sasisë e rrezikshmërisë që ato lëndë djegëse paraqesin, si dhe me pezullimin e veprimtarisë, për aq kohë sa të bëhet zëvendësimi i lëndës djegëse.

2. Kontrolli i zbatimit të këtij ligji dhe akteve nënligjore të dala në zbatim të tij , si dhe vendosja e gjobës dhe/apo pezullimi ose ndërprerja e veprimtarisë sipas legjislacionit në fuqi për inspektimin, kryhet nga struktura përgjegjëse inspektuese në fushën e mjedisit, struktura inspektuese në ministrinë përgjegjëse për industrinë dhe struktura përgjegjëse inspektuese për mbikqyrjen e tregut sipas fushës së përgjegjësisë së tyre.

3. Gjoha në zbatim të këtij neni, përbën titull ekzekutiv me përfundimin e shqyrtimit të ankimit administrativ dhe ngarkohet zyra e përmbarimit për ekzekutimin e saj. Gjoha paguhet brenda 10 ditëve nga data kur është njoftuar kundërvajtësi për vendimin e dënimit me gjobë, që përbën titull ekzekutiv, në përputhje me legjislacionin në fuqi për kundërvajtjet administrativ.

Neni 3

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në “Fletoren Zyrtare”.

K R Y E T A R I

LINDITA NIKOLLA